



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1091/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ramiz Rrustaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik Partia e Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Prishtinë, për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Ramiz Rrustaj kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik (PDK) dega në Klinë.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Ramiz Rrustaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik (PDK) dega në Klinë, me numër të partisë 99 dhe numrin e tij 29, kërkon që të hapen kutitë ngase pretendon se i mungojnë votat në Qendrat Jashanicë dhe Shtupel, në QV 0814, 3 VV në Shtupel, QV 0807 dhe 4 VV Jashanicë. Ankesës i ka bashkangjitur disa foto.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankimore të Ramiz Rrustaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunal, në ankesën e tij se i mungojnë votat në Qendrat e Votimit të cekura me lartë, PZAP-i i vlerëson si pabazuar dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, ngase nuk janë precizuar se sa vota pretendon se i ka pasur dhe sa i mungojnë, ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1091/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike:

Ndaj ketij vendimi mund te paraqitni ankese ne Gjykatën Supreme te Republikës së Kosovës, brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes se vendimit nga PZAP-i.